

Flamurtari/ Skuadra rrezikon te penalizohet rende

nga AlbaniaSoccer
E diel, 15 Shtator 2013 21:06



Flamurtari rrezikon te denohet 6 ndeshje pa tifozet ne stadiumin e saj. Kjo gje pritet te ndodhe pasi ne minuten e 40-te te pjeses se pare ne ndeshjen Flamurtari-Skenderbeu u qellua dy here me grushte presidenti i klubit te Skenderbeut z.Ardjan Takaj. Ngjarja u be e nder kur disa tifozet ne tribune po shanin vazhdimisht dhe ne kor kapitenin Blendi Shkembi dhe z.Takaj ju beri thirrje me nervozizem qe tifozet mos te shanin me, por hasi ne grushtet e nje personi qe ndodhej ne tribunen VIP praktikisht mbas shpines se tij. Personi u shoqerua ne drejtorine e policise Vlore. Nga burime te sigurta prane fshf , mesuam se do te merren masa te ashpra kunder dhunes ne stadione. Delegati i fshf Uvil Zajmi ka regjistruar gjithcka ne lidhje me kete ngjarje.